**MONEX INVESMENT LIMITED SHPK**

**NIPT: M11329034P**

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 31 / 08 2022, u perpilua dhe u nenshkrua kontrata e shitjes e kuotave nga personat e mëposhtëm:

1. **Znj. Donika Dervishi**, shtetase shqiptare, e datelindjes 16.10.1961, lindur dhe banues ne Tirane, me numer personal ID G16016129K, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar;
2. **Z. Sevket Ayaksiz**, shtetas turk, i datelindjes 04.02.1990, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U20598586, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar;
3. **Znj. Aysegul Ayaksiz**, shtetase turke, i datelindjes 04.11.1990, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U20596091, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar;
4. **Z. Emre Kaya**, shtetas turk, i datelindjes 05.07.1992, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U21097266, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar;

Të sipërpërmendurit, bazuar në nenin 73/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë Monex Invesment Limited Shpk, hartuan me vullnetin e tyre te lire kete "Kontrate për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

### Neni 1

### Palët kontraktuese

1. **Znj. Donika Dervishi**, shtetase shqiptare, e datelindjes 16.10.1961, lindur dhe banues ne Tirane, me numer personal ID G16016129K, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ortake e vetme e 100% të kuotave të shoqërisë "Monex Invesment Limited" SHPK, me NIPT: M11329034P dhe seli ne : Rruga "Ndre Mjeda", Qendra Condor Center, Kulla C, kati 1, Tirane, *këtu e më poshtë referuar si* ***"SHITËSI",***

   dhe

2. **Z. Sevket Ayaksiz**, shtetas turk, i datelindjes 04.02.1990, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U20598586, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, *këtu e më poshtë referuar si* ***"BLERËSI".***
3. **Znj. Aysegul Ayaksiz**, shtetase turke, i datelindjes 04.11.1990, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U20596091, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, këtu e më poshtë referuar si **"BLERËSI".**
4. Z. **Emre Kaya**, shtetas turk, i datelindjes 05.07.1992, lindur dhe banues ne Turqi me nr. Pasaporte U21097266, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, këtu e më poshtë referuar si **"BLERËSI".**

**Neni 2**

**Objekti i kontratës**

Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi kundrejt Blerësve të 100 % (njeqind për qind) të pjesëve/kuotave ose 1 (nje) kuote/pjese të kapitalit, me një vlerë nominale prej 100,00 Leke (njeqind lekë), që Shitësi zotëron në shoqërinë "Monex Invesment Limited" Shpk, dhe transferimi i tyre, nepermjet veprimit juridik te Shit-Blerjes, te Bleresit si më poshtë:

1. Z. Sevket Ayaksiz me 33,00 Leke (tridhjetë e tre lekë) ose 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjese/kuotave te kapitalit.
2. Znj. Aysegul Ayaksiz me 33,00 Leke (tridhjetë e tre lekë) ose 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjese/kuotave te kapitalit.
3. Z. Emre Kaya me 34,00 Leke (tridhjetë e kater lekë) ose 34% (tridhjetë e katër përqind) të pjese/kuotave te kapitalit.

**Neni 3**

**Çmimi i shitjes.**

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësit është 100,00 Leke (njeqind) lekë. Palët deklarojnë që çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate eshte likujduar nga bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate.

**Neni 4**

**Detyrimet e shitësit**

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së 100 % të kuotave, që ai kishte në shoqërinë "Monex Invesment Limited" Shpk, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësve sipas pjesëve takuese të përcaktuara më lart.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë me vullnetin e tij te lire e te plote nga të drejtat që ai kishte mbi kuoten objekt i kësaj kontrate.

Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

**Neni 5**

**Detyrimet e Blerësit**

Blerësit kane paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

Bleresit bien dakord dhe marrin persiper qe menjehere pas kalimit te pronesise te mbajne ose te ndryshojne seline e shoqerise.

**Neni 6**

**Gjuha e Kontratës**

Kjo kontratë përgatitet në 3 ekzemplarë ne gjuhen shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

**Neni 7**

**Te fundit**

Pas përpilimit të kësaj kontrate, Shitësi dhe Blerësit, kuptuan dhe pranuan përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e nënshkruan atë.

**PALET:**

**SHITËSI:**

**Znj. Donika Dervishi**

Monex Invesment Limited
Sh.p.k.
NUIS : M11329034P
TIRANË - ALBANIA

______________________

**BLERËSIT:**

**Z. Sevket Ayaksiz**

______________________

**Znj. Aysegul Ayaksiz**

______________________

**Z. Emre Kaya**

______________________